

**Letër e hapur
Kryetarit të Komunës së Ferizajt z. Bajrush Xhemajli**

I nderuari z. Xhemajli,

Fillimisht, dëshirojmë të jua urojmë mandatin e fituar, duke shpresuar që katër vitet e ardhshme do t'i shfrytëzoni për prosperitetin e komunës suaj dhe përmbushjen e premtimeve të dhëna, në bazë të të cilave qytetarët ju kanë dhënë besimin.

Instituti për Studime të Avancuara GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Huluntuuese (BIRN) kanë monitoruar aktivitetet dhe premtimet e juaja, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2009. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në debatin tuaj të mbajtur në “Jeta në Kosovë”, ju keni premtuar:

- Investime në vlerë prej 120 milionë euro (premtim i Kryeministrit Hashim Thaci);
- Mbështetjen për biznesmenët dhe inkurajimin e tyre që të lajmërojnë reketimet;
- Rregullimin e kanalizimit për tërë komunën;
- Ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujërave të zeza;
- Ndërtimin e një fabrike për riciklimin mbeturinave;
- Shndërrimin e Ferizajt në një ndër qytetet më të pastërta;
- Mbjelljen e drunjve në rrugën “Ahmet Kaciku”;
- Rregullimin e sistemit të vjetruar të ujësjellësit, dhe mbulimin me ujësjellës të atyre regjioneve që ende nuk janë mbuluar;
- Ndërtimin e një unaze për shkarkimin e trafikut në qytet;
- Asfaltimin e të gjitha rrugëve primare dhe sekondare, në fshatra dhe qytet;
- Zgjerimin e rrugëve dhe sheshit;
- Rregullimin e problemit të hekurudhave;
- Ndërtimin e një nënkalimi të Shkollës Teknike dhe një nënkalimi të Xhamisë (deri në fund të vitit);
- Ndërtimin e një mbikalimi;
- Rregullimin e “Parkut të Lirisë”;
- Rregullimin e ish-shtëpisë së TMK-së dhe shndërrimin e saj në shtëpi për aktivitete kulturore;
- Hapjen e një galerie të arteve;
- Funksionalizimin e Muzeut Historiko-Etnografik të qytetit;
- Lobimin për ndërtimin e një stadiumi olimpike në hapësirën afër hallës së sporteve;
- Krijimin e kushteve sa më të mira për studime: rritjen e hapësirave, pasurimin e bibliotekave me libra, lehtësimin e udhëtimeve, akomodimin për studime, ndarjen e bursave si dhe krijimin e mundësive për të studiuar jashtë vendit;
- Depolitizimin e shkollave;
- Rregullimin e rrethojave në të gjitha shkollat;
- Lirimin e hapësirave publike;
- Ndërtimin e një parku rekreativ në Grykën e Jezercit
- Ndërtimin e pendës për akumulim të ujërave në Jezerc;

- Rregullimin e kanalizimit në Dremjak;
- Ndërtimin e shkollës fillore në fshatin Silvovë;
- Ndërtimin e një shkolle moderne në fshatin Komogllavë me vlerë prej rreth 2 milion euro;
- Ndërtimin e fushës së futbollit në Komogllavë (gjatë vitit të parë të mandatit);

Për fund, ju bëjmë me dije se Instituti GAP dhe BIRN, në fund të çdo viti kalendarik, do të dalin me raporte vlerësuese rreth përmbushjes së premtimeve të dhëna nga kryetarët e komunave.

Ju urojmë qeverisje të suksesshme dhe shpresojmë në bashkëpunimin tuaj edhe në të ardhmen.

Sinqerisht,

Instituti për Studime të Avancuara GAP
Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)